



Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri

Ditën e sotme, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" ka shënuar një hap të rëndësishëm drejt thellimit të bashkëpunimit me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) në Shqipëri. Rektori i Universitetit të Elbasanit, Prof.dr. Skender Topi dhe Ambasadori i Prezencës së OSBE në Shqipëri, Z. Bruce G. Berton, kanë nënshkruar një marrëveshje që synon të themelojë Klinikën e Ligjit në Universitetin e Elbasanit. Klinika:

- Do të ofrojë ndihmë juridike parësore për banorët me të ardhura të ulëta në qarkun e Elbasanit;
- Do t'i vijë në ndihmë praktikës së studentëve të vitit të pestë të Drejtësisë.

Në kuadër të kësaj marrëveshje, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, do të mbështesë stafin akademik dhe studentët me trajnime, me literaturë dhe bazë materiale, si edhe eksperiencë për zhvillimin dhe menaxhimin e një klinike të ndihmës juridike dhe programit praktik të formimit juridik. Rektori në fjalën e tij, shprehu angazhimin e pakushtëzuar për këtë bashkëpunim, partneriteti i së cilës do të sjellë avantazhe të mëdha për komunitetin universitar të Elbasanit dhe më gjerë. Ambasadori Berton, shfaqti kënaqësinë e tij për lidhjen e thellë të bashkëpunimit me një institucion të rëndësishëm arsimor si Universiteti i Elbasanit dhe shprehu besimin e tij në suksesin e themelimit të klinikës së ligjit, si edhe të projekteve të përbashkëta në të ardhmen.



Fakulteti Ekonomik zhvilloi Konferencën e 11-të Ndërkombëtare Shkencore

Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", zhvilloi Konferencën e 11-të Ndërkombëtare Shkencore "Sfidat e fundit në Inovacionin e Sipërmarrjes dhe Kornizën Ligjore". Në fjalën e saj, Zëvendësrektorja e Universitetit, Prof. Asoc. Dr. Elvira Fetahu, diskutoi mbi nevojën dhe rëndësinë e kërkimit shkencor në Universitetin e Elbasanit dhe zbatimit të projekteve të lidhura me kërkimin, me financim kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo konferencë ndërkombëtare, kthyer në një traditë në Fakultetin Ekonomik, ofron për studiues, kërkues nga vende të ndryshme një platformë të shkëlqyer për të diskutuar ide, perspektiva, për të sjellë këndvështrime të reja, duke krijuar një dialog të pasur dhe të frytshëm.

Sesion dhurimi vullnetar të gjakut në UE



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar Dega Elbasan dhe Bankën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, organizuan sesion dhurimi vullnetar të gjakut në ambientet e universitetit, nën moton "Dhuro gjak, shpëto një jetë!". Si çdo vit tjetër, u vërejt një gatishmëri e madhe e studentëve, personelit akademik dhe punonjësve tjerë të këtij institucioni për t'ju bashkuar kësaj nisme, kontributi i të cilëve do t'ju vijë në ndihmë fëmijëve Talasemikë.

Sesion informimi



Partners Albania në bashkëpunim me Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", organizoi sesionin e informimit mbi Thirrjen e Parë për Aplikime, të projektit "Challenge Fund". Objektivi i këtij projekti është të ofrojë mbështetje financiare dhe teknike për rreth 50 startup-e dhe ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme shqiptare me zgjidhje inovative në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre, përmes skemave konkurruese të mbështetjes, rrjetëzimit dhe ekspozimit në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare.